

Rrjeti i Punës i të Gjelbërve Europeanë

Principet Drejtuese të Partisë së Fjelbër Europiane

Adoptuar në Kongresin e 2^{të}
Gjenevë, 13-14 Tetor 2006

Kush jemi ne?

Të Gjelbrit Europeanë me krenari mbështesin mendimin për një zhvillim të qëndrueshëm të njerzimit mbi planetin Tokë, një mënyrë zhvillimi që respekton të drejtat e njeriut dhe ngre bazat e përgjegjësishë për mjedisin, lirinë, drejtësinë, ndryshueshmërinë dhe kundër dhunës.

Lëvizja e Gjelbër Europiane zhvillohet në Europë në kohën kur kontinenti ishte ndarë prej Luftës së Ftohtë dhe po ndiente krizën energjitike. Në këtë kohë, bëhet e qartë që pjesa e zhvillimit ekonomik ishte e paqëndrueshme dhe ishte duke e shpënë planetin dhe banuesit e saj në një rrezik të madh ambjental, social dhe ekonomik. Partitë politike egzistuese ishin të paafta që të mund të punonon me këto ndryshime.

Lëvizja jonë shtrihet në disa fusha sociale : aktivitete mjedisore dhe anti – nukleare të aktivistëve tanë që lidhen me dëmtimet në rritje të planetit tonë ; aktivistë të paqes kundër dhunës të cilët japin dhe promovojnë alternativa të tjera për të zgjidhur konfliktet; lëvizjet feministe, të cilat luftojnë për një barazi të vërtetë ndërmjet burrit dhe gruas; lëvizjet për liri dhe për të drejtat e njeriut që luftojnë kundër regjimeve diktatoriale dhe totalitare; lëvizja për solidaritet e botës së tretë që mbështet fundin e kolonizimit dhe më shumë lidhje të balancuar ekonomike ndërmjet Jugut dhe Veriut të planetit tonë; fushatë e aktivistëve kundër varfërisë dhe për drejtësi sociale me shoqatat tona.

Prej këtyre origjinave, të Gjelbërit Europeanë u bashkuan së bashku për të krijuar familjen tonë politike. Ne jemi për një Europë të lirë, demokratike dhe sociale gjithmonë në paqe, dhe një botë me një mjedis të qëndrueshëm. Ne mbrojmë vlera të tilla sic është drejtësia, të drejtat humane dhe të qytetarëve, solidaritetin, qëndrueshmërinë dhe të drejtat e secilit individ për të shpënë përpara jetën e tij personale, pa pasur frikë.

Që në fillim, të Gjelbrit kanë punuar për të menduar në mënyrë globale dhe të vepronjë në mënyrë lokale. Për të zhvilluar bashkëpunimin në një nivel European, është krijuar një rrjet bashkëpunimi në vitin 1984, duje e transformuar më pas vetveten në 1993 në Gederatën Europiane të Partive të Gjelbra Europiane. Në vitin 2004, duke nënvizuar objektivat për një bashkëpunim më të thellë, Federata u transformua përsëri në Partinë e Gjelbër Europiane. Të Fjelbërit Europeanë janë pjesë e lëvizjes së Gjelbër globale.

Principet Drejtuese

Principet drejtuese të cilat do të sigurojnë rrjetin e punës për kryerjen e veprimeve politike prej Partive anëtare të Partisë së Gjelbër Europiane mund të përkufizohen si më poshtë :

Përgjegjësitë për Mjedisin

Të marri përgjegjësi për biosferën tonë është një nga detyrat e kryesore të vlerave të të Gjelbërve. Shoqëria varet nga resurset ekologjike dhe nga shëndeti mbarëbotëror, dhe në sjellim një nga obligimet të akumuluarua gjatë viteve për brezat e ardhshëm për të mbrojtur këtë trashëgimi.

Ne mbështesim fort nevojën për të jetuar me mjetet ekologjike të tonat. Ne duhet të mbajmë diversitetin biologjik dhe të luftojmë ngrohjen globale nëpërmjet përdorimit të qëndrueshëm të resurseve të rinovueshme dhe përdorimit me kujdes të resurseve jo – të riciklueshme. Përdorimi i përgjegjshëm i bio – diversitetit është me një rëndësi kritike për sigurimin e ushqimit, shëndetit dhe të nevojave të tjera të popullsisë botërore gjithmonë në rritje. Por ndërmjet cdo nocioni të nevojshmërisë, të Gjelbrit besojnë se secila prej specieve të gjalla të ndryshme në planetin tonë ka një vlerë të pazëvendësueshme dhe për këtë është e nevojshme të jetë e mbrojtur.

Pasuria jonë Europiane e prodhimit, e konsumit dhe e tregtimit po kontribuojnë në varfërinë e vazhdueshme e pjesës më të madhe të banorëve të planetit duke shkaktuar një degradim të madh të mjedisit dhe instabilitet klimatik. Vëndet e industrializuara dhe vendet në industrializim nuk mund të qëndrojnë më pa ju përgjigjur këtyre ndryshimeve. Nevoja urgjente për të ndryshuar këto pasuri është i nevojshëm një process rregullimi I thellë nëse ne jemi të gatshëm për të reaguar ndaj këtij ndryshime revers të planetit tonë.

Ndryshimet politike me të cilat ne po përballemi janë fillimi i ristrukturimit të agendës globale, kështu politikat ekonomike dhe tregtare shërbejnë për objektivat sociale dhe mjedisore dhe jo vetëm si tregues ekonomik. Përgjigja jonë është zhvillim i qëndrueshëm, i cili integron objektivat mjedisore, sociale dhe ekonomike për të mirën e përgjithshme. Zhvillim i qëndrueshëm mund të arrihet vetëm nëpërmjet bashkëpunimit global për të kapërcyer kontradiktat ekonomike që egzistojnë ndërmjet vëndeve të zhvilluara, vëndeve në zhvillim dhe vëndeve të industrializuara. Secili qytetar I botës ka të njëjtat të drejta për një ndarje të drejtë të resurseve që egzistojnë në botë dhe njëkohësisht të mbajë të njëjtën përgjegjësi për të siguruar që brezat e ardhshëm mund të gëzojnë të njëjtat të mira materiale.

Të Gjelbrit gjithmonë kanë qenë të aftë për të aplikuar principe paraprake. Ne nuk do të mbështesim masa të cilat shfaqin dëme potencialisht të mëdha për shëndetin ndaj humanëve ose për mbarëvajtjen e mjedisit. Por gjithashtu ne nuk mund të mbështesim dështim në implementimin e masava paraprake të vecanta, ato do të mbështeten vetëm në rastet në të cilat studimet në një fushë të caktuar do të jenë të shumta në numër. Gjithmonë kërkesa për paqe, energji, ushqim dhe bujqësi, shkencat jetësore, transport, teknologji, mjeksi, vendimet dhe veprimet duhet të ndërmerren duke ndjekur sistematikisht opsionet e fundit dhe më të fortat.

Në mënyrë specifike përsa i përket energjisë nukleare, të Gjelbrit janë për një Europë pa presencën e energjisë nukleare, për faktin se sjellin dëmtime civile dhe militare, për të keqen që kultivohet për brezat e ardhshëm, dhe për shkak të aparatit të fortë të sigurisë që nevojitet

për të. Për të Gjelbrit, prioritet është zhvillimi i decentralizuar dhe të rinovimit alternativave për energjinë.

Liri nëpërmjet Vetë-Determinimit :

- **Autonomia Individuale**

Ne të Gjelbrit besojmë se të gjithë humanët duhet të mos të jenë të dalluar nga seksi, moshë, orientimi seksual apo identiteti, origjina etnike apo paaftësitë, duhet të kenë të drejtë të bëjnë zgjedhjen e tyre, të shprehin vetveten në mënyrë të lirë dhe t'i japin formën që duan jetës së tyre personale pa u ndikuar negativisht nga mendime të tjerëve. Kjo liri nuk është ekskluzive për të pasur anën materiale ; ajo përfshin dimensione sociale, kulture, intelektuale dhe shpirtërore të jetës humane.

Këto të drejta duhet të garantohen nga ligji dhe të mësohen në shkollë si baza fundamentale e shoqërisë tonë. Këto duhet të plotësohen dhe të mbështeten nga të gjithë njerzit, nga mundësia e të gjithëve si burrat ashtu edhe gratë në mënyrë që të vënë në jetë për veten e tyre dhe të familjeve të tyre dhe në ataraste që është e nevojshme nga mbështetje sociale dhe materiale, të mjaftueshme për të pasur një jetë dinjitoze dhe për të marrë pjesë plotësisht në shoqëri. Në të gjitha ato vende ku këto të drejta nuk janë, ne të Gjelbrit do të luftojmë për ti pasur ato, duke propozuar solidaritet, edukim, zhvillim, bashkëpunim dhe mbrojtje nga dhuna, presioni dhe diskriminimi.

- **Demokracia Përfshirëse**

Besimi ynë në demokraci është bazuar mbi një njohje të heshtur të të gjithë individëve si të barabartë. Për të inkurajuar një nivel maksimal të veprimit, të procesit politik të vendimmarrjes duhet të jetë demokratik, përfshirës, transparent dhe plotësisht i pranueshëm dhe të jepet në mënyrë të kuptueshme për njerzit e thjeshtë. Ndryshimet radikale kanë nevojë për zhvillim të qëndrueshëm dhe është e nevojshme që të marrin pjesë dhe të marrin përgjegjësitë e tyre të gjithë njerzit dhe gjithashtu kërkohet një ndarje e drejtë e të mirave materiale. Përfaqësuesit e zgjedhur kanë për detyrë të konsultohen dhe të informojnë në mënyrë të plotë zgjedhësit e tyre gjatë gjithë procesit të vendimmarrjes.

Ne duhet të mendojmë gjithmonë në mënyrë globale, edhe atëherë kur duhet të veprojmë në mënyrë lokale. Për të siguruar nivelin më të lartë të përfshirjes së qytetarëve dhe për të pasur sukses autoriteti për të vendosur duhet të përfshijë edhe nivelet efektivisht më të ulëta. Në rast të kundërt, në të gjitha rastet kur problemi kërkon një veprim të një niveli të lartë, konsekuencat për nivelet më të ulëta, duhet të merren parasysh dhe të respektohen diferencat. Interesave të minoritarëve duhet t'u jepet vëmëndja dhe kujdesi i duhur.

Ne jemi në veprim për të forcuar demokracinë në të gjithë Europën, në nivele lokale, rajonale, kombëtare dhe mbikombëtare. Ne duam të forcojmë përgjegjësinë demokratike dhe efikasitetin e institucioneve vepruese.

Zgjerimi i Drejtësisë

Politikat e Gjelbra janë bazuar në principet e drejtësisë. Kjo kërkon një shpërndarje të mirave të shoqërisë dhe kjo si përfundim kërkon një vëmëndje të vecantë për nevojat e më të dobëve. Vëmëndja ndaj më të dobëve është në mënyrë të vecantë në nivelin global, ku Europa ka një përgjegjësi specifike për të stimuluar rritjen ekonomike në vëndet në zhvillim. Ne duhet të drejtojmë problemet për të ndryshuar botën, nocioni ynë për drejtësinë shkon më larg sesa politikat tradicionale të dhëna më parë. Të Gjelbrit janë për drejtësi sociale, për të drejtat e barabarta për gratë, për drejtësi midis brezave, dhe për drejtësi në nivelin global. Panvarësisht nga konfliktet praktike që janë midis tyre, këto dimensione për drejtësi nuk duhet të kthehen për të qënë kunder njëri – tjetrit.

- **Drejtësia sociale** siguron që cdonjëri të ketë akses në resurset vitale dhe sociale: shkollimi, punë dhe pjesëmarrje demokratike. Një akses i drejtë duhet të mbrohet përballë jodrejtësisë sociale egzistuese, dhe ka nevojë të mbrohet institucionalisht. Shkollimi është një factor vendimtar në mënyrë që t'i japi formë jetës së secilit person. Duke përdorur aftësitë e punës tonë na bën net ë aftë që të arrimë frutet e aftësive që kemi duke i dhënë një përkufizim të saktë identitetit tonë. Pjesëmarrja demokratike është një është një kërkesë bazë për të qënë të pëefshirë në shoqëri dhe për të ndihmuar që ti japim formë asaj.
- **Barazia gjinore.** Drejtësia është gjithashtu një e drejtë gjinore. Gruaja dhe burri duhet të gëzojnë të njëjtën fuqi dhe kështu t'i japin një përkufizim se si do të jetë zhvillimi i shoqërisë më pas. Gjithmonë, ato duhet të jetojnë jeten e tyre ne paqe. Ne të Gjelbrit duam të zhvillojmë rrjetin e punës institucionale e cila garanton barazinë e gruas në shtëpi, në punë, në mjediset publike, dhe ne pozicione të tjera me influencë. Ne duam të lehtësojmë harmonizimin në familje dhe në jetën profesionale për të dyja gjinitë.
- **Drejtësi midis brezave.** Motoja jonë është "Ne vetëm kemi **borroëed** botën nga fëmijët tanë" është më e volitshme për tu thënë në ditët e sotme sesa kurrë më parë. Sot, e ardhmja e fëmijëve tanë është në rrezik. Drejtësi ndërmjet brezave do të thotë një obligim për brezat më të vjetër për të marrë në dorësdhënë në dorëzim trashëgiminë ambientale, sociale dhe kulturore më të rinjve në një mënyrë të qëndrueshme. Ajo gjithashtu përfshin një obligim për brezat më të rinj për tu kujdesur për brezat më të vjetër të popullatës. Ajo duhet të sigurojë që të gjithë brezat mund të marrin pjesë plotësisht në shoqëri.
- **Drejtësi globale.** Drejtësia është gjithashtu një çështje shumë e rëndësishme për ne dhe kjo e fundit e vlersuar në një nivel ndërkombëtar. Si një ekonomi globale të bashkohen njerzit dhe të rritet panvarësia jonë, ky moral i obliguar bëhet një zhvillim praktik i yni. Zhvillimi mbarëbotëror i qëndrueshëm dhe të drejtat universale të njeriut janë në qëndër të vëmëndjes për plotësimin e konceptit tonë mbi drejtësinë globale. Kjo duhet të vihet në qëndër të vëmëndjes për prej një institucioni me një rrjet pune të pavarur monitorimi për të dhënë përgjegjësi sociale dhe për të pasur një treg të lirë.

Drejtësia kërkon solidaritet, jo – diskriminim dhe përfshirjen e qytetarëve. Solidariteti ndihmon në lrijimin e vetë-kofidencës individuale – ajo forcon qytetarët në vend që ti bëjë ata padronë. Të gjitha autoritetet publike duhet të punojnë në bashkëpunim me qytetarët për

të krijuar dhe për të konsoliduar institucionet të cilat mbështesin solidaritetin. Për këtë arsye ne duam të investojmë në rrjete pune dhe komunitete, të cilat, me inkurajimin e shtetit, praktikojnë një mbështetje të heshtur.

Diversiteti, një Kusht i Pazëvendësueshëm

Shoqëria, civilizimi dhe kultura janë zhvilluar nëpërmjet ndryshueshmërisë. – Ne të Gjelbrit jemi vetvetja si rezultat i ndërmarrjes së veprimtarisë për lëvizjen sociale, dhe ne besojmë në diversitet si një nga kushtet e suksesit, si edhe të egzistencës, në të gjitha fushat e aktivitetit. Diversiteti rrit mabshkëveprimin ndërmjet organizatave dhe grupeve kudo që ato janë përballur me ndryshime të papritura. Ajo është një masë paraprake kundër intolerancës, ekstremizmit dhe totalizimit. Dhe ajo është një burim inspirimi për gjëra të reja.

Diversiteti human ka një sërë dimensionesh : gjinore, sociale, kulturele, shpirtërore, filozofike, fetare, gjuhësore, ekonomike, etnike, seksuale, rajonale. Kjo mund të shprehet prej individëve ose prej grupeve sociale. Ne e mbështesim diversitetin. Ajo asnjëherë nuk duhet të përdoret si preteks për çështjet e të drejtave universale.

Aty ku njerzit ndjanë të njëjtën hapësirë të kufizuar, diferencat mund të merren në mënyrë të lehtë si difekte. Edhe në komunitete dhunë të vogla, më i forti ka tendencën që të përdori rolin e tij dominant ndërsa më o dobtin ndihet i shtypur gjithnjë e më shumë, duke e shtyrë vetveten për ti dhënë kurajë. Diversiteti duhet mbrojtur në ato momente që rrezikohet dhe ka nevojë për njohje, kuptim i heshtur dhe respekt – dhe sa herë të jetë e nevojshme, mbrojtje active.

Jo - Dhunës

Format kundër dhunës janë një pjesë kryesore i kapacitetit filozofik i teorisë të të Gjelbërve dhe kushtet tona për të arritur në zgjidhjen e të gjitha problemeve. Nuk duhet të jepet zgjidhja e fundit ndaj cdo konflikti ndërmjet individëve, grupet sociale apo Shtetet mund të detyrohen me forcë. Një princip bazik i të gjelbërve është që mjetet e përdorura për të arritur një objektiv duhet të jenë të përpueshme me objektivin në vetvete. Kështu që kërkimi politik për drejtësi dhe paqe nuk mund të arrihet me mjete dhune.

Violenca nuk është vetëm fizike. Veprimi human dhe strukturat ekonomike globale mund të deprimojnë njerzit për të drejtat e tyre humane dhe do të shpërndante një padrejtësi sociale. Varfëria për shembull është një nga dormat më të shfaqura të violencës. Për të eliminuar varfërinë ne promovojmë trupa ndërkombëtare të cilat kanë si qëllim barazinë ekonomike dhe që të vendosin njerzit që të bëjnë një jetesë të sigurtë në rradhë të parë, ashtu sikurse edhe për vendosjen e rregullave globale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut.

Për sa kohë konfliktet e armatosura janë të lejuara, ne jemi të bindur që përdorimi i armëve ose i forcave policore si një strategji e izoluar nuk mund të ketë sukses për një kohë të gjatë. Të Gjelbrit duan të shohin sa më pak ndërhyrje ushtarake dhe implementimi i konceptit të një politike për siguri civile. Kjo kërkon zhvillimin e ështëjeve të rëndësishme për parandalimin si edhe menaxhimin e konflikteve civile.

Më shumë se kurrë të Gjelbrit njohin faktin që ndërhyrja ushtarake ndaj një konflikti të mundshëm mund të bëhet vetëm me anë të vendimit të komunitetit ndërkombëtar si zgjidhja e fundit e mundshme për tu arritur. Aty ku është një dëmtim apo një masë e

dhunshme kundër civilëve, përdorimi i forcave ushtarake të paqeruajtësve mund të justifikohet dhe të konsiderohet si dicka e dobishme. Aty ku masat paraprake kanë dështuar ndërhyrja e armatosur mund të jetë e nevojshme. Vëzhgimi i mjeteve ushtarake do të jetë subjekt i rregullave dhe ligjeve ndërkombëtare dhe është dhe lihërisht i takon vetëm atij ligjërisht të ndjekë kushtet të cilat hasen në momente të caktuara:

- Egzistenca e një mandati të Këshillit të Sigurisë të UN ;
- Pakti i objektivave kryesore për ndërhyrje në mënyrë që të mbrojnë dhe të shpëtojnë jetë njerëz nëpërmjet mospërdorimit të dhunës;
- Egzistenca e një politike të përcaktuar se si do të bëhet ndërhyrja e këtyre trupave dhe kur duhet të mbarojë dhe si do të arrihet vendosja e paqes dhe stabilizimi i situatës egzistuese.

Për të përmbledhur të gjithën, Zhvillimi i Qëndrueshëm.

Të Gjellbrit njohin vlerat e përgjegjësive ambjentale, drejtësisë, lirisë, diversiteti si edhe paqja mund të jenë dhe janë çështje të cilat përkrahen edhe nga familje të tjera politike. Ajo çfarë përkufizojnë të Gjellbrit është që ne konsiderojmë këto vlera si të ndërvarura nga njëra – tjetra si edhe të pandara. Si një e tërë, ato e përkufizojnë të gjitha veprimet tona në një zgvillim të qëndrueshëm social, cultural, ambjental dhe ekonomik të shoqërisë tonë në planetin Tokë. Ne aplikojmë këto jo vetëm për politikën tona të jashtme por edhe në politikën tonë të brendshme dhe na drejtojnë ne se si të udhëheqim partinë tonë.

Europeanët ishin pionierë të procesit të industrializimit I cili është në zemër të disa problemeve më të rënda globale. Si qytetarë të një kontinenti më të dëmtuar në Tokë, ne Europeanët kemi një përgjegjësi më të madhe për mbeturnat dëmprurëse të cilat kanë sjellë dhe kjo ka drejtuar drejt gjetjes së alternativave dhe modele të zhvillimit të qëndrueshëm. Qëllimi i këtyre çështjeve fillimisht duhet të meeret në konsideratë nga të gjitha shtetet për të arritur qëllimin kryesor. Kështu ne kemi nevojë për një bashkëpunim në të gjithë Europën – nga Dublini në Tbilisi, nga Helsinki në Lisbon, nga Ankaraja në Reykjavik – do të jenë të aftë për të marrë pjesë.

Europa e Bashkuar është në një vend të duhur për të lehtësuar këtë bashkëpunim, duke siguruar që

- Ajo do të mbetet e hapur për një zgjerim të mëtejshëm;
- Ajo do të ristrukturojë vetveten në një institucion të vërtetë demokratik,
- Ajo do të riorientojë prioritetet e saj drejt një modeli zhvillimi të qëndrueshëm social dhe mjedisor dhe
- Ajo merr përgjegjësitë e saj globale, nën Shtetet e Bashkuara, dhe në bashkëpunim me institucione të tjera të vlefshmesic janë OSCE dhe Këshilli I Europës, për paqe dhe për një botë të qëndrueshme.